



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____.r./v.



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe neneve 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit - parashtresës të dorëzuar nga parashtrues i njohur, në vazhdimin e dytë të seancës së 50 -të të mbajtur me datë 23.07.2021 morri

VENDIM

Denoncimi për korrupsion me nr. 12-1495/ 1 të datës 08.04.2021, të dorëzuar nga parashtruesi -----
----- nga -----, **NDËRPRITET.**

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente të kompetencës së mëtjshme për të vepruar mbi pohimet në lëndën me numër 12-1495 të vitit 2021 të formuar sipas denoncimit me nr. 12-1495 / 1 të datës 08.04.2021 dhe lëndën do ta dorëzoj për veprim kompetent në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lënda me numër 12 -1495 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri të parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Lënda me numër 12 - 1495 e vitit 2020, e formuar pas denoncimit – parashtresës me numër 12 - 1495 të datës 08.04.2021, e dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) nga parashtruesi,
„----- nga -----.

Në denoncim janë nxjerrë pohime kundër personit -----, Udhëheqës i departamentit dhe mjek në -----
----- "në -----, për shkak të dyshimit për sjellje të korruptuar dhe konflikt
interesi.

Gjatë shqyrtimit të pohimeve të përfshira në denoncim, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit i merr parasysh të njëjtat dhe konstaton se në rastin bëhet fjalë për dyshim të sjelljes korruptive dhe konflikt të interesave të personit -----, Udhëheqës i departamentit dhe mjek në -----
„----- "në ----- _ gjegjësisht, siç thuhet në kërkesë, mjeku në fjalë kërkoi ryshfet për ty kryer detyrimet e tij të rregullta. Në denoncim gjithashtu parashtruesi deklaroi se ai tashmë i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë - Inspektoratit Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor, për të cilin ka paraqitur dëshmi të

kërkesës, një kopje të Ankesës të paraqitur të marrë nga Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor me datë 22.02. të vitit 2021.

Për të përcaktuar situatën faktike, KSHPK iu drejtua Ministrisë së Shëndetësisë - Inspektoratit Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor me Kërkesë për dorëzimin e informacionit shtesë në lidhje me lëndën me numër 12-1495 / 2 të datës 08.07.2021.

KSHPK morri njoftim nga Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor ku thuhet se MSH -ISHSSH "nuk ka fuqi të veproje" në lidhje me pohimet në lëndën dyshuese.

Duke pasur parasysh të konstatuarën më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit përcaktoi se në këtë rast bëhet fjalë për pohime të lidhura me veprimin kompetent të organit tjetër kompetent, gjegjësisht veprimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe vlerësoi se Komisioni Shtetëror nuk ka elemente të kompetencës së mëtejshme të cituar në lidhje me të njëjtën, dhe procedura sipas lëndës me numër 12-1495 të vitit 2021 e formuar sipas denoncimit me nr. 12-1495 / 1 të datës 08.04.2021, të mbyllet dhe arkivohet dhe ti dorëzohet veprimit kompetent të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te: Arkivi, Parashtruesi

Puno: K.Z.

Miratoi: NB, anëtar i KSHPK - së